



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 638/19
657/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga Operatorët Ekonomik “LAGUNA” SH.P.K – Prishtinë, me nr. 638/19, si dhe ankesës së OE “Krasniqi” SH.P.K – Prishtinë, me nr. 657/19, kundër njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: N.SH “Clean”; “Linda” SH.P.K ; “Gani Mlinaku B.I” - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemaili, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevorë” me nr. prok: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK - Prishtinë” më datën 30.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “LAGUNA” SH.P.K – Prishtinë, me nr. 638/19, dhe ankesa së OE “Krasniqi” SH.P.K – Prishtinë, me nr. 657/19, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemaili, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevorë” me nr. prok: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK - Prishtinë”.

II. ANULOHET, vendimi i AK - Njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemaili, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevorë” me nr. prok: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK - Prishtinë”, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: OE “LAGUNA” SH.P.K – Prishtinë, dhe ankesës së OE “Krasniqi” SH.P.K – Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara ankuesve ju bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 17.05.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 02.08.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 02.08.2019.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 11.09.2019.

Data e njoftimit për pezullimin e aktivitetit të prokurimit është bërë me dt: 30.09.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 22.09.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 24.09.2019.

Operatori ekonomik ankues: OE “LAGUNA” SH.P.K – Prishtinë, me nr. 638/19, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 27.09.2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemaili, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjellbër dhe Mehmet Xhevorri” me nr. prok: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK - Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 68 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues “Krasniqi” SH.P.K – Prishtinë, me nr. 657/19, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 04.10.2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemaili, Asim Vokshi, Dardania,

Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjellbër dhe Mehmet Xhevari” me nr. prok: 616-19-3237-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “KK - Prishtinë” duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60, 61, 68, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 10.10.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit, në raportin e datës: 21.10.2019, ka sqaruar pretendimet e OE ankues: “LAGUNA” SH.P.K – Prishtinë, dhe OE: “Krasniqi” SH.P.K – Prishtinë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Laguna”Shpk se AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ka rekomanduar si fitues të mundshëm ofertën e grupit të OE NSH “Clean” ; “Linda” Shpk; “Gani Mlinaku B.I” e cila nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit ekonomik dhe financiar të dosjes së tenderit,ku është kërkuar që Qarkullimi i mjeteve financiare në tri vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) të jetë minimum 1,500,000.00 €dhe OE i rekomanduar për kontrate në ofertën e tij nuk ka fare deklaratat tatimore dhe me këtë rast AK ka bërë shkelje të nenit 68 të LPP-së Gjendja Ekonomike dhe Financiare, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

AK me datë 21.06.2019 përmes [B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara](#) të publikuar në e-prokurim tek kapaciteti ekonomik dhe financiar nga OE kërkohet që Qarkullimi i mjeteve financiare në tri vitet e fundit(deri në datën e publikimit të njoftimit) të jetë minimum 1,500,000.00 € e dëshmuar me Deklaratën tatimore mujore për tri vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) nga Administrata Tatimore e Kosovës(ATK).

Grupi i OE NSH “Clean” ; “Linda”Shpk; “Gani Mlinaku B.I” me rastin e dorëzimit të ofertës së tyre në e-prokurim nuk ka dorëzuar/ngarkuar deklaratën e qarkullimit financiar.

Në raportin e vlerësimit të tenderëve nga komisioni i vlerësimit është vlerësuar që kërkesa administrative për qarkullimin ekonomik dhe financiar është në pajtim me kërkesën e Dosjes së Tenderit. Lidhur me këtë kam kontaktuar zyrtarët përgjegjës të prokurimit ne KK Prishtinë dhe kam kërkuar që a është dorëzuar se bashku me ofertën edhe kjo deklaratë apo nëse AK gjatë fazës se vlerësimit të tenderëve ka kërkuar informata shtese konform nenit 72 të LPP-së nga grupi i OE NSH “Clean” ; “Linda”Shpk; “Gani Mlinaku B.I” lidhur me

deklaratën e qarkullimit ekonomik dhe financiar. Nga dokumentet e pranuar nga KK Prishtinë nuk ka ndonjë kërkesë për informata shtesë për qarkullimin ekonomik dhe financiar. Nga personi i autorizuar i OE NSH "Clean" kam kërkuar sqarime me shkrim se a ka dorëzuar deklaratën për qarkullim ekonomik dhe financiar, nga i cili përmes e-mailit kam pranuar deklarata të bankave për qarkullim bankar. Këto deklarata nuk janë konform kërkesës së Dosjes së tenderit sepse deklarata e qarkullimit ekonomik dhe financiar duhet të jetë deklaratë tatimore mujore për tri vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Konsideroj që AK ka bërë shkelje të nenit 68 të LPP-së "Gjendja Ekonomike dhe Financiare" dhe nenit 72 të LPP-së "Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë" duke mos kërkuar informacione shtesë. **Konstatohet se ky pretendim ankimor është i bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Laguna" Shpk se AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ka rekomanduar si fitues të mundshëm ofertën grupit të OE NSH "Clean"; "Linda" Shpk; "Gani Mlinaku B.I" e cila nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të dorëzojë Deklaratë origjinale të nënshkruar dhe vulosur se do të paguaj përvojën e punës së punëtorëve në vlerë mujore prej 1,390.00 €, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë në deklaratën e tij ka deklaruar që do të paguaj përvojën e punës prej 1,147.00 €

Në deklaratën e dorëzuar nga grupi i OE NSH "Clean"; "Linda" Shpk; "Gani Mlinaku B.I" së bashku me ofertën është deklaruar që do të paguaj përvojën e punës në shumë mujore prej 1.147.00 € sipas kërkesës së Dosjes së tenderit. Me datën 03.06.2019 në pyetjen e një OE, AK jep sqarime shtesë në lidhje me pagesën e përvojës së punës se "Shuma për përvojën e punës është ajo që është specifikuar në dosje 1,147.00 €. Po ashtu AK me datë 24.06.2019 përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar pagesa e përvojës së punës në vlerë mujore prej 1,390.00 €. Meqenëse Formulari për korrigjimin e gabimeve është i datës së më vonshme atëherë vlera e pagesës mujore të përvojës së punës duhet të merret shuma 1,390.00 €.

Konstatohet se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht kërkesat 6, 7, 8 dhe 9. AK me datë 23.08.2019 përmes letrës standarde për sqarimin e tenderëve ka kërkuar nga grupi i OE NSH "Clean"; "Linda" Shpk; "Gani Mlinaku B.I" që të dorëzojë dëshmitë e dokumenteve të kërkuara sipas kërkesave të pikës 9.1 të Dosjes së tenderit.

Grupi i OE NSH "Clean"; "Linda" Shpk; "Gani Mlinaku B.I" ka dërguar certifikatat ISO 9001 2015, ISO 14001 2015, OHASAS 18001 2007, por këto certifikata nuk janë të noterizuara sipas kërkesës nr. 8 të DT. Gjithashtu ka dërguar edhe listën e pajisjeve konform kërkesës 9 të dëshmuar me fatura, kontratë huazimi, librezë të vlefshme për njërin nga pajisjet dhe të noterizuara sipas kërkesës së DT. OE "Clean" ka

dëshmuar edhe 6 kontrata për punëtor konform kërkesës nr. 7 për mbrojtje fillestare nga zjarri se bashku me certifikatat profesionale. Kontratat nuk janë të noterizuara dhe përvoja e punës nuk është e dëshmuar me trust pensional siç është kërkuar në DT. Ndërsa sa i përket kërkesës së 6, një menaxher kontrate-Me përvoje pune se paku 5 vite në lëmine e njëjtë nga OE "Clean" nuk është dëshmuar në ofertën e dorëzuar. Konstatohet se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Konsideroj se pretendimet ankimore të OE "Laguna" janë të bazuara.

Pretendimet e OE ankues "Krasniqi" Shpk për Grupin e OE NSH "Clean" ; "Linda" Shpk ; "Gani Mlinaku B.I". Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional, ku OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) minimum 1,000,000.00 euro. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e shërbimeve dhe OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar kontrata që nuk mund të konsiderohen të ngjashme me shërbimet e mirëmbajtjes së shkollave por shumica e kontratave të ofruara janë kontrata për punë, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. OE NSH "Clean" ; "Linda" Shpk ; "Gani Mlinaku B.I" ka ofruar kontrata të realizuara për secilin anëtar të grupit, duke i prezantuar disa tabela që nuk janë konform tabelës së aneksit 6 dhe aneksin 6 nuk e ka plotësuar fare. Në tabelën e pare të ofruar për OE "Clean" janë prezantuar tri referenca: Referenca e parë për kontratën e realizuar për "Pastrimin dhe mirëmbajtjen higjienike të objekteve të Komunës së Ferizajt" në vlerë prej 209,398.00 € e përmbush kërkesën e DT. Kontrata ka filluar me datë 16.03.2015 me afat 24 muaj. Gjithashtu edhe referenca për kontratën me Ministrinë e Punëve të Brendshme për "Shërbimet e pastrimit të objekteve të MPB-së" e lidhur me datë 25.07.2016 me afat deri 31.07.2017 përmbush kërkesën e DT, por në këtë reference nuk ka çmim total dhe nuk dihet sa ka qene shuma e kontratës së realizuar. Ndërsa referenca e tretë e prezantuar në listën e kontratave dhe referencave për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objektit të Qendrës së Shërbimit Emergjent Primar-Ferizaj në vlerë prej 38,400.00, në dokumentacionin e ofertës së dorëzuar nuk ka reference të prezantuar. Sa i përket listës së ofruar për OE "Ambienti" (anëtar i grupit), të dy referencat e ofruara, Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara në qytetin e Mitrovicës në vlerë prej 640,000.00 € dhe referenca për mirëmbajtjen e varrezave dhe lapidarëve në qytetin e Mitrovicës sipas përshkrimeve të referencave këto kontrata janë kontrata për punë dhe nuk mund të konsiderohen kontrata të ngjashme. Lista e ofruar nga OE "Linda" (anëtar i grupit ekonomik) nga përshkrimi i projekteve rezulton se këto kontrata janë kontrata për punë. Edhe dy kontratat e bashkëngjitura në këtë tabelë për nga numri i prokurimit 655-16/068-511 dhe 655/16-068-521 me titull "sanimi dhe rregullimi i infrastrukturës ekzistuese në territorin e Komunës Shtërpçë dëshmohet se këto

kontrata janë kontrata për punë dhe nuk mund të konsiderohen kontrata të ngjashme për mirëmbajtjen higjienike të shkollave. AK me rastin e shqyrtimit të kërkesave për rishqyrtim duhet të ofroj arsyetime të detajuara se cilat kontrata të OE i ka vlerësuar se përmbushin kërkesën e përcaktuar në DT. **Konstatoj se ky pretendim ankimor është i bazuar**

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Krasniqi" Shpk se shuma e ofertës së rekomanduar për kontrate prej 1,077,182.85 € nuk e mbulon shpenzimet e pagave për 83 punëtor me page mujore bruto prej 282.50 € duke ofruar një analizë të detajuar për kalkulimin e pagave dhe si e tille kjo ofertë duhet të shpallet e papërgjegjshme, ekspert i shqyrtues ka këtë mendim. Në Dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të pranoj të punësoj 83 punëtore (69+14) me page bruto prej 282.50 € duke i kalkuluar sipas rregullave të ATK-së dhe OE duhet të deklarohet se do ti kryej të gjitha obligimet financiare për kontributet e punëtorëve dhe do ti respektoj të drejtat e tyre sipas ligjit të Punës. Sipas një analize të thjeshte kalkulimi i pagave duket kështu:

Paga bruto për 1 punëtore	282.50
Kontrib pension punëdhënësi	
5%	14.13
Totali i pagës	296.63
pagat për 83 punëtor	24,619.88
Përvoja e punës mujore 1390.00	1,390.00
Totali I pagesë pa TVSH	26,009.88
TVSH 18%	4,681.78
Totali I pagesë me TVSH	30,691.65
Totali I pages per 36 muaj	1,104,899.49

Pretendimi i OE ankues qëndron ngase oferta e shpallur si fituese (1,077,182.85 €) është më e vogël sesa analiza e prezantuar. Nëse kësaj analize i shtojmë edhe rritjen e pagës baze prej 4% vjetore sipas sqarimeve shtesë të AK të datës 29.07.2019 atëherë pragu i mbulimit të shpenzimeve të pagave do të jetë edhe më i lartë. **Konstatoj se ky pretendim ankimor është i bazuar.**

Lidhur me pretendimet tjera të OE ankues "Krasniqi" Shpk lidhur me atë se grupi i OE NSH "Clean" ; "Linda" Shpk ; "Gani Mlinaku B.I" nuk i përmbush edhe kërkesat tjera teknike dhe financiare, siç janë mungesa e dëshmisë së qarkullimit financiar, nuk ka ofruar dëshmi për menaxherin e kontratës, nuk ka ofruar dëshmi të trustit për 6 punëtor për mbrojtje fillestare nga zjarri, ka prezantuar certifikatat ISO por nuk i ka

noterizuar janë pretendime të njëjta me OE ankues "Laguna" për të cilat kam dhënë përgjigjen më lartë dhe se këto pretendime janë të bazuara. **Konsideroj se pretendimet ankimore të OE "Krasniqi" janë të bazuara.**

Pretendimet e OE ankues "Krasniqi" Shpk për OE "Laguna". Sa i përket pretendimit të OE "Krasniqi" Shpk se OE "Laguna" Shpk nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin e mjeteve financiare për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, dëshmi deklarata tatimore mujore për tre vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit nga ATK por ka ofruar deklarata vjetore, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE "Laguna" Shpk në momentin e dorëzimit të ofertës përmes sistemit e-prokurimi ka dorëzuar edhe deklaratat tatimore vjetore(ATK) për vitet 2016,2017 dhe 2018. Nëse e marrim vetëm deklaratën tatimore të vitit 2017 ku të ardhurat bruto janë 1,392,818.25 € dhe deklaratën tatimore të vitit 2018 ku të ardhurat bruto janë 1,428,155.31 €,atëhere konsiderojmë që OE "Laguna" Shpk ka përmbushur kërkesën për qarkullim financiar në shume prej 1,500.00 € për tri vitet e fundit. **Konstatohet se ky pretendim ankimor është i pazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE "Krasniqi" Shpk se OE "Laguna" Shpk tek lista e pajisjeve nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme siç është kërkuar në dosje të tenderit se çdo OE duhet të ofroj një listë të pajisjeve e cila duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedurë en-minutes dhe deklarata e ofruar nga OE "Laguna" Shpk nuk korrespondon me kërkesat e dosjes së tenderit.

OE "Laguna" Shpk ka ofruar listën e pajisjeve siç është kërkuar nga Dosja e tenderit dhe kjo listë është noterizuar tek noteri Sefedin Blakaj me akt en-minutes, me nr të referencës 1931/19 dhe deklarata e noterizuar e përmbush kërkesën e dosjes se tenderit. **Pretendimi ankimor është i pazuar.**

OE "Laguna" Shpk ka ofertuar me çmim total prej 1,089,213.39 € dhe bazuar në analizën e shpenzimeve për pagat e 83 punëtorëve të pasqyruar më lartë(1,104,899.49 €) dhe sqarimeve shtese nga AK se çdo ofertë që nuk mbulon shpenzimet e pagave të 83 punëtorëve do të trajtohet si çmim jo normalisht i ulët, **konsideroj se oferta e OE "Laguna" është nën pragun e mbulimit të shpenzimeve të pagave të punëtorëve.**

Pretendimet e OE ankues "Krasniqi" Shpk për OE "MSS". Sa i përket pretendimit të OE "Krasniqi" Shpk se OE "MSS" Shpk nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin e mjeteve financiare për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, dëshmi deklarata tatimore mujore për tre vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit nga ATK por ka ofruar deklarata tatimore vjetore, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE "MSS" Shpk në momentin e dorëzimit të ofertës përmes sistemit e-prokurimi ka dorëzuar edhe deklaratat

tatimore vjetore(ATK) për vitet 2016,2017 dhe 2018. Nëse e marrim vetëm deklaratën tatimore të vitit 2018 ku të ardhurat bruto janë 2,684,714.72 € dhe deklaratën tatimore të vitit 2017 ku të ardhurat bruto janë 2,630,878.77 €,atëhere konsiderojmë që OE "MSS" Shpk ka përmbushur kërkesën për qarkullim financiar në shume prej 1,500.00 € për tri vitet e fundit. **Konstatohet se ky pretendim ankimor është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE "Krasniqi" Shpk se OE "MSS" Shpk tek lista e pajisjeve nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme siç është kërkuar në dosje të tenderit se çdo OE duhet të ofroj një listë të pajisjeve e cila duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedurë en-minutes dhe deklarata e ofruar nga OE "MSS" Shpk nuk korrespondon me kërkesat e dosjes së tenderit . OE "MSS" Shpk ka ofruar listën e pajisjeve siç është kërkuar nga Dosja e tenderit dhe kjo listë është noterizuar tek noteri Sefedin Blakaj me akt en-minutes, me nr të referencës 1956/19 dhe deklarata e noterizuar e përmbush kërkesën e dosjes se tenderit. **Pretendimi ankimor është i pabazuar.**

OE "MSS" Shpk ka ofertuar me çmim total prej 1,089,432.36 € dhe bazuar në analizën e shpenzimeve për pagat e 83 punëtorëve të pasqyruar më lartë(1,104,899.49 €) dhe sqarimeve shtese nga AK se çdo ofertë që nuk mbulon shpenzimet e pagave të 83 punëtorëve do të trajtohet si çmim jo normalisht i ulët. **Konsiderohet se oferta e OE "MSS" Shpk është nën pragun e mbulimit të shpenzimeve të pagave të punëtorëve.**

Pretendimet e OE ankues "Krasniqi" Shpk për Grupin e OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Krasniqi" Shpk se Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin e mjeteve financiare për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit,dëshmi deklarata tatimore mujore për tre vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit nga ATK por ka ofruar deklarata vjetore,eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Grupi i OE "Saf" Shpk; "Integral" Shpk në momentin e dorëzimit të ofertës përmes sistemit e-prokurimi ka dorëzuar edhe deklaratat tatimore vjetore(ATK) për vitet 2016,2017 dhe 2018. Nëse e marrim vetëm deklaratën tatimore të vitit 2018 ku të ardhurat bruto janë 6,631,732.86 € dhe deklaratën tatimore të vitit 2017 ku të ardhurat bruto janë 1,444,143.33 €,atëhere konsiderojmë që Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk ka përmbushur kërkesën për qarkullim financiar në shume prej 1,500.00 € për tri vitet e fundit.

Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Krasniqi" Shpk se Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk nuk përmbush kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional, ku OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë) minimum 1,000,000.00 euro. Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk ka dorëzuar një listë të kontratave të bashkangjitur me referenca dhe kontrata për secilin anëtarë të konzorciumit.

Anëtari konzorciumit OE "Saf" Shpk ka dorëzuar një kontratë të lidhur me 06.04.2016 me Komunën e Gjakovës për "Mirëmbajtjen e ndërtesave të drejtorive komunale për vitin 2016. Kjo kontratë nuk është e dëshmuar me referencë dhe nuk dihet sa është shuma e kontratës së realizuar. Gjithashtu ka dorëzuar edhe një kontratë me Komunën e Vitisë për "Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore" e lidhur me 01.09.2017 deri me 31.08.2018 në vlerë prej 109,043.64 €. Nuk ka referencë të bashkangjitur për këtë kontratë. OE "Saf" ka dorëzuar edhe disa kontrata dhe referenca me operator privat për ofrimin e shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes por që nuk arrijnë ta përmbushin shumën e kontratave të realizuara prej 1,000,000.00€. Anëtari i konzorciumit OE "Integral" Shpk ka prezantuar listën e kontratave të bashkangjitur edhe disa kontrata dhe referenca, por lista e kontratave dhe kontratat me referenca nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme të kërkuar sipas DT. Pothuaj të gjitha kontratat e prezantuara janë kontrata për asfaltimin e rrugëve, mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrugëve regjionale dhe këto kontrata janë kontrata për punë dhe nuk përmbushin kërkesën e DT për kontratat të ngjashme. **Pretendimi ankimor është i bazuar**

Sa i përket pretendimit tjetër tek kapaciteti teknik/profesional se Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk nuk ka dorëzuar kontratat e punës për 6 punëtorë për mbrojtje fillestare nga zjarri, lista e pajisjeve nuk është e noterizuar dhe nuk ka dorëzuar asnjë deklaratë për kërkesat 2,3,4 dhe 5 tek kapaciteti teknik/profesional i DT. Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk ka dorëzuar certifikatat e trajnimit për mbrojtje nga zjarri por nuk ka dëshmi për kontratë apo CV dhe pagesën e trustit pensional. Lista e pajisjeve për realizimin e punëve nuk është e noterizuar siç është kërkuar në DT. Deklaratat se OE do të punësojë 83 punëtorë (69+14), se do të paguajë pagën bruto prej 282.50 €, deklaratën se të drejtat e punëtorëve do të realizohen konform rregullave dhe ligjeve të aplikuara në Kosovë duke përfshirë edhe përvojën e punës, deklaratën se materialet e përdorura janë bio dhe të atestuara, kërkesa konform DT (kërkesa 2,3,4,dhe 5) nuk janë dorëzuar nga ky konzorcium. **Pretendimi ankimor është i bazuar.**

Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk ka ofertuar me çmim total prej 1,094,949.62 € dhe bazuar në analizën e shpenzimeve për pagat e 83 punëtorëve të pasqyruar më lartë (1,104,899.49 €) dhe sqarimeve shtese nga AK se çdo ofertë që nuk mbulon shpenzimet e pagave të 83 punëtorëve do të trajtohet si çmim jo normalisht i ulët. **Konsideroj se oferta e Grupit të OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk është nën pragun e mbulimit të shpenzimeve të pagave të punëtorëve. Konsideroj që pretendimet e OE "Krasniqi" janë pjesërisht të bazuara.**

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të pranohen pjesërisht për arsyet që i theksuam në përgjigje të pretendimeve ankimore të më sipërme.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta kthejë në RIVLERËSIM aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemaili,

Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevorii” me nr. prok: 616-19-3237-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Prishtinë”.

Autoriteti kontraktues, me datë: 24.10.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “LAGUNA” SH.P.K – Prishtinë, me datë: 23.10.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “Krasniqi” SH.P.K – Prishtinë, me datë: 23.10.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.10.2019, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-ve ankuese, përfaqësuesit e AK-së, si dhe eksperti profesional i prokurimit, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesat e operatoreve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së të parë ankues z. Krasniqi deklaroi:

Ne qëndrojmë pranë ankesës tonë dhe pajtohemi pjesërisht me mendimin e ekspertit për arsyet si në vijim: Në ankesën tonë ne kemi cekur të gjitha pretendimet tona të cilat i kemi të bazuara në LPP por edhe në ligjet tjera në fuqi konform kërkesave të AK-së në këtë Aktivitet të Prokurimit:

Grupi i OE i rekomanduar për kontratë, nuk e përmbushë kërkesën 1 të kapaciteteve teknike dhe profesionale, ku OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme (duke filluar nga data e publikimit) të njoftimit për kontratë (minimum 1,000,000 €). Mandej grupi i OE fitues nuk e ka plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit (që është obligativ), ku duhet të saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe përfundimit dhe përfituesin. OE i rekomanduar për kontratë, ka ofruar kontrata që nuk mund të konsiderohen të ngjashme me shërbimet e pastrimit të shkollave, por shumica e këtyre kontratave janë kontrata pune. Konsorciumi ka ofruar kontrata për asfaltimin e rrugëve, zgjerimin e rrugëve, rregullimin e urave, renovimin e objekteve etj, këto kontrata i ka ofruar OE LINDA SHPK, ndërsa OE tjetër i konsorciumit, AMBIENTI ka ofruar kontrata për mirëmbajtjen e varrezave dhe mirëmbajtjen e lapidareve, kontrata të cilat as nuk janë të përafërta me natyrën e punës që do të bëhet në këtë projekt (PASTRIM). Edhe Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar. Përveç këtij kriteri

kualifikues Konsorciumi i OE nuk i përmbushë edhe kriteret si në vijim: OE fitues nuk ka ofruar dëshmi për menaxherin e kontratës. 1 menaxher me kontratë me përvojë pune 5 vite në lëmin e njëjte të dëshmohet me kontratë pune, CV, reference dhe trust pensional siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në sqarimet shtesë - përmirësimin e gabimeve. OE fitues nuk ka ofruar dëshmi për 6 punëtorët e certifikuar për mbrojtje fillestare të zjarrit, ai ka ofruar certifikata nga zjarri por nuk ka ofruar, CV, referencë dhe trustin pensional, siç është kërkuar tek kërkesat dhe dëshmitë në dosje të tenderit dhe në sqarimet shtesë - përmirësimin e gabimeve. OE fitues nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin e mjeteve financiare për 3 vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit minimumi 1,500,000.00 € siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në sqarimet shtesë - përmirësimin e gabimeve, dëshmi: deklarate tatimore mujore për 3 vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit nga ATK.

OE fitues nuk ka ofruar dëshmi për listën e pajisjeve siç është kërkuar në kriteret e dosjes së tenderit dhe në sqarimet shtesë - përmirësimin e gabimeve, që lista e pajisjeve të jetë e noterizuar me procedure en-minutes nga noteri.

1. Tek specifikimet teknike të detyrueshme AK ka kërkuar nga OE që me rastin e dorëzimit të ofertës pranon kushtet në vijim: mirëpo, Konsorciumi i OE fitues, MSS, Laguna, Konsorciumi Saf & Integral nuk ka ofruar dëshmi se i pranon këto kushte siç është kërkuar në dosjen e tenderit.
 - a. Se do të punësoj minimum 69 punëtorë nga Lista e Autoritetit Kontraktues dhe për kryerjen e shërbimeve do të shtoj edhe 14 punëtorë-pastruese nga personeli i tij.
 - b. se do të paguan punëtorëve pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori në bruto prej 282,50 euro.
 - c. se pagat a punëtorëve do të paguaj për muajin paraprak, me sa largu deri me datë 05 të muajit në vijim, pa marrë parasysh pagesën e bërë nga AK.
 - d. se të drejtat dhe detyrat e punëtorëve do të realizohen konform rregullave dhe ligjeve të aplikuara në Kosovë, duke përfshirë edhe pagesën për përvojën e punës të punëtorëve nga lista e Autoritetit Kontraktues, e cila momentalisht është në shumën mujore prej 1.390.00 euro pa TVSH
 - e. se materialet e përdorura janë bio dhe të atestuara.

Konsiderojmë se autoriteti kontraktues respektivisht komisioni vlerësues dhe menaxheri i prokurimit jo vetëm që kanë bërë shkelje të dispozitave të LPP-se, duke mos respektuar kriteret e përzgjedhjes, por, njëkohësisht kanë bërë vepër penale pasi që komisioni vlerësues nuk merr për bazë kriteret kualifikuese dhe gjithashtu menaxheri i prokurimit edhe pas kërkesës për rishqyrtim, konsideron se me rastin e përzgjedhjes AK ka bërë vlerësim konform kërkesave të caktuara, andaj në kërkesën për rishqyrtim kemi parashtruar pyetje në vijim, e të cilat menaxheri i prokurimit është dashur të jap përgjigjeje pasi pyetjet kanë qenë të qarta dhe të cilat mbeten edhe për ekspertin respektivisht OSHP të vlerësoj se:

- Cilat janë referencat që ka ofruar OE i rekomanduar ?
- Iso standarde nuk i ka te noterizuar siç është kërkuar në FTD ?
- A i përmbush OE kërkesat e AK për pagesën e punëtorëve duke përfshi obligimet apo deklaratimet e kërkuara?
- Ç'fare forme janë noterizuar dokumentet respektivisht lista e pajisje pasi që në dosje shumë qarte është kërkuar?
- A është plotësuar aneksi 6 i dosjes sipas kërkesave?
- Çmimi i ofruar e i mbulon Kërkesat e AK për numrin e punëtorëve?
- A është përcaktuar menaxheri i projektit dhe sa do të jetë paga e tij

Tek pjesa II. Përshkrimi i Çmimeve, konsorciumi i OE fitues ka ofruar çmim vjetor sipas përshkrimit të çmimeve me vlerë prej 1,077,182.85 €, ku ky çmim vjetorë shumëzohet për 3 vite kap vlerën prej 3,231,548.22 €. Si është e mundur që komisioni vlerësues dhe Menaxheri i Prokurimit të shpallin këtë konsorcium të OE fitues me këtë çmim enorm, kur dihet qarte se vlera e parashikuar e kontratës është 1,270,000.00 €. Prova në vijim për Konsorciumin e cekur më lartë: Përshkrimi i Çmimeve

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr. i art.	Përshkrimi	njësia matëse	sasia	çmimi për njësi Pa TVSH €	TVSH (%)	çmimi për njësi ME TVSH €	ÇMIMI MUJOR ME TVSH €	ÇMIMI VJETOR ME TVSH €
1	Hapësirat e mbrendshme	m2	34112.52+1.934.70= 36.047.22	0.59	18	0.70	25098.07	903458.68
2	Sipërfaqet e gjelbruara	m2	26774.00+1560= 28.334.00	0.1	18	0.12	3343.41	120362.83
3	asfalt	m2	2.642.00	0.07	18	0.08	218.23	7856.25
4	beton	m2	9396.00+490=9.886.00	0.05	18	0.06	583.27	20997.86
5	fusha sportive	m2	9.615.20	0.06	18	0.07	680.76	24507.22
totali i përgjithshëm:								1077182.85

Sa i përket ekspertizës së ekspertit, tek grupi i OE fitues NSH. Clean & Gani Millaku B.I, pajtohem në përgjigjet e pretendimeve të ekspertit, mirëpo, tek pretendimet e OE Laguna SHPK, MSS dhe Grupi i OE SAF SHPK & INTEGRAL pajtohem pjesërisht. Ku ne do të japim disa sqarime në lidhje me kapacitetet financiare dhe listën e pajisjeve me procedurën en-minutes sipas sqarimeve shtese të dosjes së tenderit të datës 24.06.2019, ku thuhet: Kërkesa 1. Qarkullimi i mjeteve financiare në tre vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) minimum 1.500.000,00 €. Dëshmia 1. Deklaratën tatimore Mujore për tre vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) nga Administratat Tatimore e Kosovës (ATK). Sa i përket pretendimit, tek kapacitetet financiare ne nuk kemi thënë se të gjithë këta OE të cekur më lartë nuk e plotësojnë qarkullimin, por ne kemi sqaruar se këta OE nuk kanë ofruar dëshmi financiare ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe sqarimet shtese ku thuhet: Deklaratë tatimore mujore për 3 vitet e fundit deri

në datën e publikimit të njoftimit nga ATK, por kanë ofruar deklarata vjetore ose qarkullime bankare, të cilat nuk janë konform dosjes së tenderit dhe sqarimeve shtesë. Sa i përket pretendimit të listës së pajisjeve AK ka kërkuar që lista e pajisjeve të jetë e noterizuar me procedure en-minutes, mirëpo OE Laguna dhe MSS kanë prezantuar vetëm deklarata juridike me aktin en-minutes e jo procedure siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe sqarimet shtesë: Sipas ligjit numër 03/L-010 për Noteri, neni 3, dispozita 3.1 shkruan: akti en-minutes është dokument te cilin Noteri duhet ta depozitoj dhe ta ruaj ne shënimet e tija apo te saj noteriale dhe nga i cili mund të nxirret kopje autentike apo ekstrakt ne kushte te caktuara (pra Noteri sipas kësaj procedure detyrohet te dale ne vendin e ngjarjes dhe te konstatoj gjendjen faktike te mjeteve). Ndërsa tek deklaratat juridike të OE të lartcekur tek pika 3 thotë: Vërejtje: “Këshillohet dhe njoftohet deklaruesi edhe pala e trete se Noteri me rastin e noterizimit te kësaj deklarate nuk ka mundur te beje lidhjen ne mes pajisjeve te listuara ne aneksin 1, 2 dhe 3 dhe faturave te pajisjeve te bashkangjitura dosjes se kësaj deklarate. Përderisa është dhënë kjo deklaratë nga ana e Noterit atëherë vërehet qartë se nuk është bërë proceduar EN-Minutes konform, ligjit numër 03/L-010 dhe nuk plotëson kërkesën e AK sepse noteri në këtë rast është i obliguar të dal në vendin e ngjarjes ose vend punishte dhe ti verifikoj me procesverbal listën e mjeteve në prani të komisionit siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe sqarimet shtesë . Dhe vetë noteri nuk jep garanci se mjetet e prezantuara në listë janë pronë e OE-së. Pra në këtë pretendim nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit për arsyet e lartë cekura pra ligji për noterin në Kosovë e dallon qartë se çka është procedura EN-MINUTES dhe deklarata juridike ose në rastin në fjalë është bërë në një lloj forme nga noteri vërtetim i origjinalitetit të Listës POR JO EDHE PAJISEVE QË DUHET TË VËRTETOHEN SIPAS KËSAJ PROCEDURE.

Vërejtjet tona ndaj Komisionit të vlerësimit janë: sepse ky Komision i vlerësimit ka analizuar të gjithë tenderët dhe ka konstatuar së të gjithë janë të përgjegjshëm, kjo nuk qëndron për faktin se ky komision nuk ka bërë vlerësim të drejtë por ka bërë vlerësim të gabuar, favorizues dhe njëkohësisht manipulues, sepse, si është e mundur që të gjithë këta OE të shpallën të përgjegjshëm por jo të suksesshëm, mandej vërejtje tjetër është se Zyrtari Përgjegjës i prokurimit nuk ka shqyrtuar asnjë argument që ka parashtruar konzorciumi OE “Krasniqi” Shpk.

Pra , nga faktet e lartcekura shihet se, 4 OE: N.SH. CLEAN & N.SH AMBIENTI.G & SHPK LINDA ; MSS ; SAF SHPK & INTEGRAL SHPK; LAGUNA SHPK, nuk i plotësojnë kriteret administrative. Mandej, përveç qe nuk i plotëson kriteret nga ana administrative te 4^{er} OE te larte cekur është dashur te trajtohen si te pa përgjegjshëm, sepse te gjithë këta OE janë me çmim të papërgjegjshëm. Këtë konstatim po e elaborojme me tabelën ne vijim: Në raport e Vlerësimit të AK thuhet se komisioni ka konstatuar se tenderuesi me çmimin me të ulet 1,077,182.85 € i plotëson kërkesat financiare pasi që pagat me TVSH për 36 muaj paraqesin një vlerë prej 1,055,097.00 €, duke u bazuar në këtë, komisioni ka konstatuar se çmimi prej 1,077,182.85 € i plotëson kërkesat e AK dhe të njëjtin e ka rekomanduar për kontratë.

Kontributi i punëdhënësit 5%		
14.13	83	1,172.79 €
përvoja e punës punëtor		1,390.00 €
TOTALI PA TVSH		26,010.29 €
TVSH		4,681.85 €
Totali me TVSH		30,691.14 €
Total i pagesës për 36 muaj		1,104,899.49 €

Ky konstatim nuk qëndron. Mirëpo, në FDT nuk janë cekur vetëm pagat dhe TVSH, por, është kërkuar edhe përvoja e punës me vlerë prej 1,390.00€ mujore, rritja 4%, menaxheri i

kontratës dhe materiali, të cilat duhet të llogariten sipas ligjeve në fuqi si dhe të gjitha tatimet të tjera që burojnë sipas ligjit. Paga bruto për një punëtorë në FDT dhe sqarimet është 282.5 euro bruto Plus 5% kontributet e punëdhënësit. Kalkulimi i pagës për një punëtorë sipas ATK-se me page bruto 282.5 euro është $282.5 \times 83 \text{ punëtorë} = 23,447.50$ kontributi i punëdhënësi $14.13 \text{ Euro} \times 83 = 1,172.79$ plus përvoja 5 % dhe përvoja e punës në vlerë prej 1,390.00. Paga Bruto 282.5.

Pra nga kjo konstatim se të gjithë OE që janë nën këtë çmim duhet të shpallen të pa përgjegjshëm sipas kriterëve të dosjes së tenderit dhe sqarimeve shtese të dosjes së tenderit prove: Kur kësaj Analize i shtohet edhe rritja prej 4% sipas sqarimeve shtese të dosjes së tenderit të datës 29.07.2019 në vlerë prej 1,106.39 €, me TVSh, nuk i mbulon shpenzimet sipas kërkesave të FDT. Mirëpo në dosjen e tenderit është kërkuar edhe një menaxher dhe materiali për pastrim. Ky pretendim ka qenë i bazuar edhe nga Eksperti Shqyrtues po e

NR	Operatoret Ekonomik	Vendi	Çmim	Vërejtje
1	grupi i OE N.SH. Clean ; Linda Shpk	Prishtinë	1,077,182.85 €	Jo
2	Laguna SHPK	Prishtinë	1,089,213.39 €	Jo
3	grupi i OE Schafberger & Erik	Prishtinë	1,180,072.65 €	Jo
4	grupi I OE Krasniqi & Beni	Prishtinë	1,178,339.49 €	Jo
5	OE MSS	Prishtinë	1,089,432.36 €	Jo
6	Gurpi I OE SAF Shpk & Integral	Prishtinë	1,094,949.62 €	Jo

prezantim edhe regjistrin e ofertave sipas proces verbalit të hapjes .

AK-K. K. Prishtinë në përgjigjen e ekspertizës nuk pajtohet me mendimin e Ekspertit dhe thotë:

“Kalkulimi i pagave është bërë sipas kalkulimit të ankuesit jo në mënyrë profesionale, pasi që në kërkesat, sqarimet tona dhe konstatimet e vendimit për rishqyrtim janë paraqitur qartë të gjitha të dhënat dhe është sqaruar se çmimi i tenderuesit të propozuar i mbulon detyrimet ligjore. Eksperti sikurse ankuesi me apo pa qëllim e shtojnë kontributin pensional në pagën bruto edhe pse asnjë rregullore nga ATK nuk e parasheh këtë, ATK vetëm e ndanë këtë kontribut nga pjesa që tatohet”. Ky konstatim i AK nuk qëndron sepse sipas

Ligjit për paga dhe pensione Neni 37: pika 4.1 ; 4.2 dhe 4.6. Neni 37- Tatimi i mbajtur në burim në paga pagesa dhe pensione, Udhëzimi administrativ nr 01/16 Pika 4.1. Punëdhënësi kryesor dhe ai sekondarë kontribuon me pesë përqind (5%) mbi pagën bruto të të punësuarit. Pika 4.2. Zbret pesë përqind (5%) nga paga bruto e të punësuarit dhe i paguan në emër të kontributit pensional. Pika 4.6. Sipas paragrafit 4, në paragrafët 4.1 dhe 4.2 të këtij neni, Kontributi pensional minimal pesë përqind plus pesë përqind (5%+5%), paguhet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Edhe në vitin 2017 kemi pasur një situatë të njëjtë rreth kësaj çështje po nga i njëjti Institucion K. K. Prishtinë Pastrimi i Shkollave, kemi edhe vendimin e OSHP-së me numër 358/17 të datës 03.11.2017 ku citohet: Paneli Shqyrtues pas shkresave të lëndës, Shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtimin kryesorë, sqaron se AK gjatë vlerësimit të ofertave dhe me rastin e rekomandimit për kontratë nuk i ka marrë parasysh të gjitha kërkesat e paraqitura tek kapacitetet teknike dhe profesionale në lidhje me pagën bruto të punëtorëve. Paneli Shqyrtues vjen në përfundim se gjatë ri-vlerësimit të ofertave, AK duhet të bëjë analize detale të çmimeve dhe të bëhet kalkulimi i kontributeve të punëtorëve konform legjislacionit në fuqi dhe rregullave të ATK-së duke pasur parasysh edhe kontributin e punëdhënësit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së së dytë ankuese z. Ademi deklaroj: Sa i përket pretendimeve tona ankimore pajtohem me mendimin e Eksperti Shqyrtues. Ndaj OE të rekomanduar për kontratë. Ne nuk pajtohem me pretendimin e OE ankues Krasniqi ndaj OE Laguna sa i përket pretendimit që jemi nder paga të punëtorëve. Dua ta sqaroj se për këtë AP janë kërkuar 83 punëtorë me paga prej 282.5 euro bruto. $83 \times 282.5 = 23\,447.5$ euro kësaj vlere ia shtojë 18% TVSH = 4.220.55 euro, $23\,447.5$ plus $4.220.55 = 27.668.05$ euro kjo shume plus është kërkuar përvoja e punës 1390 euro = 29.058.05 euro për 83 punëtorë kontribute janë 1172.79 euro, $29.058.05$ plus kontributet $1172.79 = 30.230.84$ euro kjo shume x 36 muaj i bije që të jete 1.088.310.24 euro që është shume e realizueshme dhe ne përputhje të plote me pagën e kërkuar në DT. Dua ta potencoj një vendim të OSHP-së me datën 03.07.2019 që është me nr 256/19 e që Eksperti Shqyrtues ka qenë Es'heme Beka ka qenë në atë AP pothuaj se pretendimi i njëjtë i joni me këtë aktivitet vetëm ka qenë ndryshimi me paga, dhe ne kemi kalkuluar pagat e punëtorëve sipas atë Vendimi të OSHP-së e që e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit Kontraktues. Kontributi i punëtorëve është obligim të paguhet mirëpo nuk ngarkohet TVSH tek kontributit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Jashari deklaroj: Për OE Laguna tek pretendimi i parë ekzistojnë sqarime se në vendimin sipas kërkesës për rishqyrtim ku është cekur se Komisioni nuk ka kërkuar dëshmi plotësuese për qarkullimin financiar pasi që referencat e dorëzuara janë nga Institucionet

Publike dhe plotësojnë kërkesën e Autoritetit Kontraktues sepse ne kemi kërkuar te ngjashme. Lidhur me pretendimin e 2-te Autoriteti Kontraktues ka sqaruar edhe raportin e komisionit dhe vendimit për rishqyrtim se gjatë vlerësimit janë bazuar ne përvojën e punës prej 1.390 euro dhe me te njëjtën është analizuar çmimi i propozuar për dhënie te kontratës. Pretendimi i 3-te është i pa bazuar pasi sqarimet e kërkuara nga AK janë sipas nenit 72 te LPP-së dhe nenit 39.8 te RrUOPP-së. Për OE KRASNIQI, pretendimi i pare është i pa bazuar pasi qe AK ka marre për baze te gjitha referencat te cilat kanë pune me shërbimet e ngjashme me kërkesat e AK pastrim te hapësirave te brendshme dhe te jashtme. Lidhur me pretendimin e 2-te Autoriteti Kontraktues i ka sqaruar pretenduesit se Autoriteti Kontraktues gjatë analizës financiare ka mbare për bazë pagën bruto , TVSH-ne pasi kontributi prej 5% është ne kuadër te pagës bruto dhe sipas rregullave te ATK.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Papaj deklaroi: Sa i përket OE te rekomanduar i ka 3 kushte qe nuk i plotëson nga DT e para është kërkuar deklarata e qarkullimit financiar nga ATK, komisioni i vlerësimit thotë se është konform DT-së. Kam thirr zyrën e prokurimit ne Autoriteti Kontraktues se a ka dorëzuar diçka ka thënë se nuk e di, e kam thirr edhe OE-ne fitues dhe thotë se kam dorëzuar dhe me dërgon do deklarata te bankave. Sa i përket kontratave qe është kërkuar deri ne 1MLN euro OE i ka paraqit disa kontrata mirëpo shumica janë për pune.

Mbetem prapa raportit te dhënë ne ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së parë ankuese z. Krasniqi deklaroi: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të gjitha provat e prezantuara në ankesën tonë të shqyrtohen një nga një pasi që janë bazë e fortë për aprovimin e ankesës tonë, një herit kërkojmë që të aprovohet ankesa jonë dhe lënda të kthehet në Rivlerësim. Duke kërkuar nga AK që të respektoj ligjet në fuqi dhe kërkesat e parashtruara në dosje tenderi dhe sqarimet shitesë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së dytë ankuese z. Ademi deklaroi: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe lenden ta kthej ne rivlerësim dhe nëse lënda kthehet ne rivlerësim kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues qe ta këtë parasysh këtë pretendimin tone ankimor.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Jashari deklaroi: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te hedhe poshtë ankesat e OE-ve si te pa bazuara dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se lidhur me pretendimin e OE ankues "Laguna"Shpk se AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ka rekomanduar si fitues të mundshëm ofertën e grupit të OE NSH "Clean" ; "Linda" Shpk; "Gani Mlinaku B.I"

e cila nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit ekonomik dhe financiar të dosjes së tenderit, ku është kërkuar që Qarkullimi i mjeteve financiare në tri vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) të jetë minimum 1,500,000.00 € dhe OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij nuk ka fare deklaratat tatimore dhe me këtë rast AK ka bërë shkelje të nenit 68 të LPP-së Gjendja Ekonomike dhe Financiare. paneli shqyrtues konform mendimit të dhënë nga eksperti shqyrtues profesional konstaton se AK me datë 21.06.2019 përmes [B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara](#) të publikuar në e-prokurim tek kapaciteti ekonomik dhe financiar ka kërkuar që qarkullimi i mjeteve financiare në tri vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) të jetë minimum 1,500,000.00 € e dëshmuar me Deklaratën tatimore mujore për tri vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) nga **Administrata Tatimore e Kosovës(ATK)**. Grupi i OE NSH "Clean" ; "Linda"Shpk; "Gani Mlinaku B.I" të cilët janë të rekomanduar për kontratë me rastin e dorëzimit të ofertës së tyre në e-prokurim nuk ka dorëzuar/ngarkuar deklaratën e qarkullimit financiar. Në raportin e vlerësimit të tenderëve nga komisioni i vlerësimit është vlerësuar që kërkesa administrative për qarkullimin ekonomik dhe financiar është në pajtim me kërkesën e Dosjes së Tenderit. Paneli shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues profesional ka kontaktuar zyrtarët përgjegjës të prokurimit në KK Prishtinë dhe ka kërkuar që a është dorëzuar se bashku me ofertën edhe kjo deklaratë apo nëse AK gjatë fazës së vlerësimit të tenderëve ka kërkuar informata shtese konform nenit 72 të LPP-së nga grupi i OE NSH "Clean" ; "Linda"Shpk; "Gani Mlinaku B.I" lidhur me deklaratën e qarkullimit ekonomik dhe financiar. Nga dokumentet e pranura nga KK Prishtinë nuk ka ndonjë kërkesë për informata shtesë për qarkullimin ekonomik dhe financiar. Po ashtu eksperti shqyrtues profesional nga personi i autorizuar i OE NSH "Clean" ka kërkuar sqarime me shkrim se a ka dorëzuar deklaratën për qarkullim ekonomik dhe financiar, nga i cili përmes e-mailit ka pranuar deklarata të bankave për qarkullim bankar. Këto deklarata nuk janë konform kërkesës së Dosjes së tenderit sepse deklarata e qarkullimit ekonomik dhe financiar duhet të jetë deklaratë tatimore mujore për tri vitet e fundit (deri në datën e publikimit të njoftimit) nga Administrata Tatimore e Kosovës(ATK). Eksperti shqyrtues konsideron që AK ka bërë shkelje të nenit 68 të LPP-se "Gjendja Ekonomike dhe Financiare" dhe nenit 72 të LPP-së "Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë" duke mos kërkuar informacione shtesë. Andaj duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raportin e ekspertizës nga eksperti shqyrtues profesional paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi **ankimor i OE ankues është i bazuar**.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Laguna" Shpk se AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ka rekomanduar si fitues të mundshëm ofertën grupit të OE NSH "Clean" & "Linda" Shpk & "Gani Mlinaku B.I" e cila nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të dorëzoj Deklaratë origjinale të nënshkruar dhe vulosur se do të paguaj përvojën e punës së punëtorëve në vlerë mujore prej 1,390.00 €, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë në deklaratën e tij ka deklaruar që do të paguaj përvojën e punës prej 1,147.00 €, paneli shqyrtues konform sqarimeve të dhëna në raportin e ekspertizës konstaton se në deklaratën e dorëzuar nga grupi i OE NSH "Clean" ; "Linda"Shpk ; "Gani

Mlinaku B.I” së bashku me ofertën është deklaruar që do të paguaj përvojën e punës në shume mujore prej 1.147.00 € sipas kërkesës së Dosjes së tenderit. Me datën 03.06.2019 në pyetjen e një OE, AK jep sqarime shtesë në lidhje me pagesën e përvojës së punës se “Shuma për përvojën e punës është ajo që është specifikuar në dosje 1,147.00 €. Po ashtu, AK me datë 24.06.2019 përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar pagesa e përvojës së punës në vlerë mujore prej 1,390.00 €. Meqenëse Formulari për korrigjimin e gabimeve është i datës së më vonshme atëherë vlera e pagesës mujore të përvojës së punës duhet të merret shuma 1,390.00 €. Andaj duke pasur parasysh konstatimet e lartpërmendura, **paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht kërkesat 6, 7, 8 dhe 9. AK me datë 23.08.2019 përmes letrës standarde për sqarimin e tenderëve ka kërkuar nga grupi i OE NSH ”Clean” & ”Linda” Shpk & ”Gani Mlinaku B.I” që të dorëzoj dëshmitë e dokumenteve të kërkuara sipas kërkesave të pikës 9.1 të Dosjes së tenderit. Grupi i OE NSH ”Clean” & ”Linda” Shpk & ”Gani Mlinaku B.I” ka dërguar certifikatat ISO 9001 2015, ISO 14001 2015, OHASAS 18001 2007, por këto certifikata nuk janë të noterizuara sipas kërkesës nr. 8 të DT. Gjithashtu ka dërguar edhe listën e pajisjeve konform kërkesës 9 të dëshmuar me fatura, kontratë huazimi, librezë të vlefshme për njërën nga pajisjet dhe të noterizuara sipas kërkesës së DT. OE ”Clean” ka dëshmuar edhe 6 kontrata për punëtor konform kërkesës nr. 7 për mbrojtje fillestare nga zjarri se bashku me certifikatat profesionale. Kontratat nuk janë të noterizuara dhe përvoja e punës nuk është e dëshmuar me trust pensional siç është kërkuar në DT. Ndërsa sa i përket kërkesës së 6, një menaxher kontrate-Me përvoje pune se paku 5 vite në lëmine e njëjtë nga OE ”Clean” nuk është dëshmuar në ofertën e dorëzuar. **Andaj, duke pasur parasysh konstatimet e lartpërmendura, paneli shqyrtues konstaton ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues”Krasniqi” Shpk për Grupin e OE NSH ”Clean” ; ”Linda” Shpk ; ”Gani Mlinaku B.I” se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional, ku OE duhet të ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimum 1,000,000.00 euro. Një listë të kontratave të realizuara,duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e shërbimeve dhe OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar kontrata që nuk mund të konsiderohen të ngjashme me shërbimet e mirëmbajtjes së shkollave por shumica e kontratave të ofruara janë kontrata për punë, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. OE NSH ”Clean” ; ”Linda” Shpk ; ”Gani Mlinaku B.I” ka ofruar kontrata të realizuara për secilin anëtar të grupit, duke i prezantuar disa tabela që nuk janë konform tabelës së aneksit 6 dhe aneksin 6 nuk ke ka plotësuar fare. Në

tabelën e pare të ofruar për OE "Clean" janë prezantuar tri referenca: Referenca e parë për kontratën e realizuar për "Pastrimin dhe mirëmbajtjen higjienike te objekteve të Komunës së Ferizajt" në vlerë prej 209,398.00 € e përmbush kërkesën e DT. Kontrata ka filluar me datë 16.03.2015 me afat 24 muaj. Gjithashtu edhe referenca për kontratën me Ministrinë e Punëve të Brendshme për "Shërbimet e pastrimit të objekteve të MPB-së" e lidhur me datë 25.07.2016 me afat deri 31.07.2017 përmbush kërkesën e DT, por në këtë reference nuk ka çmim total dhe nuk dihet sa ka qene shuma e kontratës së realizuar. Ndërsa referenca e tretë e prezantuar në listën e kontratave dhe referencave për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objektit të Qendrës së Shërbimit Emergjent Primar-Ferizaj në vlerë prej 38,400.00, në dokumentacionin e ofertës së dorëzuar nuk ka reference të prezantuar. Sa i përket listës së ofruar për OE "Ambienti" (anëtar i grupit), të dy referencat e ofruara, Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara në qytetin e Mitrovicës në vlerë prej 640,000.00 € dhe referenca për mirëmbajtjen e varrezave dhe lapidarëve në qytetin e Mitrovicës sipas përshkrimeve të referencave këto kontrata janë kontrata për punë dhe nuk mund të konsiderohen kontrata të ngjashme. Lista e ofruar nga OE "Linda" (anëtar i grupit ekonomik) nga përshkrimi i projekteve rezulton se këto kontrata janë kontrata për punë. Edhe dy kontratat e bashkangjitura në këtë tabelë për nga numri i prokurimit 655-16/068-511 dhe 655/16-068-521 me titull "Sanimi dhe rregullimi i infrastrukturës ekzistuese në territorin e Komunës Shtërpçë dëshmohe se këto kontrata janë kontrata për punë dhe nuk mund të konsiderohen kontrata të ngjashme për mirëmbajtjen higjienike të shkollave. AK me rastin e shqyrtimit të kërkesave për rishqyrtim duhet të ofroj arsyetime të detajuara se cilat kontrata të OE i ka vlerësuar se përmbushin kërkesën e përcaktuar në DT, andaj duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues profesional, **paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Krasniqi" Shpk se shuma e ofertës së rekomanduar për kontrate prej 1,077,182.85 € nuk e mbulon shpenzimet e pagave për 83 punëtor me page mujore bruto prej 282.50 € duke ofruar një analizë të detajuar për kalkulimin e pagave dhe si e tille kjo ofertë duhet të shpallet e papërgjegjshme, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Në Dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të pranoj të punësoj 83 punëtorë (69+14) me page bruto prej 282.50 € duke i kalkuluar sipas rregullave të ATK-së dhe OE duhet të deklarohet se do ti kryej të gjitha obligimet financiare për kontributet e punëtorëve dhe do ti respektoj të drejtat e tyre sipas ligjit të Punës.

Pretendimi i OE ankues qëndron ngase oferta e shpallur si fituese (1,077,182.85 €) është më e vogël sesa analiza e prezantuar. Nëse kësaj analize i shtojmë edhe rritjen e pagës baze prej 4% vjetore sipas sqarimeve shtesë të AK të datës 29.07.2019 atëherë pragu i mbulimit të shpenzimeve të pagave do të jetë edhe më i lartë. **Duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues profesional paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar**

Lidhur me pretendimet tjera të OE ankues "Krasniqi" Shpk lidhur me atë se grupi i OE NSH "Clean" ; "Linda" Shpk ; "Gani Mlinaku B.I" nuk i përmbush edhe kërkesat tjera teknike dhe financiare, siç janë

mungesa e dëshmisë së qarkullimit financiar, nuk ka ofruar dëshmi për menaxherin e kontratës, nuk ka ofruar dëshmi të trustit për 6 punëtor për mbrojtje fillestare nga zjarri, ka prezantuar certifikatat ISO por nuk i ka noterizuar, janë pretendime të njëjta me OE ankues "Laguna" për të cilat kam dhënë përgjigjen më lartë dhe se këto pretendime janë të bazuara. **Duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues profesional paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar.**

Pretendimet e OE ankues "Krasniqi" Shpk për OE "Laguna". Sa i përket pretendimit të OE "Krasniqi" Shpk se OE "Laguna" Shpk nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin e mjeteve financiare për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, dëshmi deklarata tatimore mujore për tre vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit nga ATK por ka ofruar deklarata vjetore, paneli shqyrtues vlerëson se OE "Laguna" Shpk në momentin e dorëzimit të ofertës përmes sistemit e-prokurimi ka dorëzuar edhe deklaratat tatimore vjetore (ATK) për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Nëse e marrim vetëm deklaratën tatimore të vitit 2017 ku të ardhurat bruto janë 1,392,818.25 € dhe deklaratën tatimore të vitit 2018 ku të ardhurat bruto janë 1,428,155.31 €, atëherë konsiderojmë që OE "Laguna" Shpk ka përmbushur kërkesën për qarkullim financiar në shume prej 1,500.00 € për tri vitet e fundit, andaj **paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE "Krasniqi" Shpk se OE "Laguna" Shpk tek lista e pajisjeve nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme siç është kërkuar në dosje të tenderit se çdo OE duhet të ofroj një listë të pajisjeve e cila duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedurë en-minutes dhe deklarata e ofruar nga OE "Laguna" Shpk nuk korrespondon me kërkesat e dosjes së tenderit. OE "Laguna" Shpk ka ofruar listën e pajisjeve siç është kërkuar nga Dosja e tenderit dhe kjo listë është noterizuar tek noteri Sefedin Blakaj me akt en-minutes, me nr të referencës 1931/19 dhe deklarata e noterizuar e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit, dhe duke u bazuar në këtë paneli konsideron se pretendimi ankimor është i pabazuar.

OE "Laguna" Shpk ka ofertuar me çmim total prej 1,089,213.39 € dhe bazuar në analizën e shpenzimeve për pagat e 83 punëtorëve të pasqyruar më lartë (1,104,899.49 €) dhe sqarimeve shtese nga AK se çdo ofertë që nuk mbulon shpenzimet e pagave të 83 punëtorëve do të trajtohet si çmim jo normalisht i ulët. Paneli shqyrtues vlerëson se oferta e OE "Laguna" Shpk është nën pragun e mbulimit të shpenzimeve të pagave të punëtorëve, dhe duke u bazuar në këtë paneli konsideron se pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE "Krasniqi" Shpk se OE "MSS" Shpk nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin e mjeteve financiare për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, dëshmi deklarata tatimore mujore për tre vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit nga ATK por ka ofruar deklarata tatimore vjetore, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit profesional vlerëson se OE "MSS" Shpk në momentin e dorëzimit të ofertës përmes sistemit e-prokurimi ka dorëzuar edhe deklaratat tatimore vjetore (ATK) për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Nëse e marrim vetëm deklaratën

tatimore të vitit 2018 ku të ardhurat bruto janë 2,684,714.72 € dhe deklaratën tatimore të vitit 2017 ku të ardhurat bruto janë 2,630,878.77 €, atëhere konsiderojmë që OE "MSS" Shpk ka përmbushur kërkesën për qarkullim financiar në shume prej 1,500.00 € për tri vitet e fundit prandaj **duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues profesional paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar.** Lidhur me pretendimin e OE "Krasniqi" Shpk se OE "MSS" Shpk tek lista e pajisjeve nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme siç është kërkuar në dosje të tenderit se çdo OE duhet të ofroj një listë të pajisjeve e cila duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedurë en-minutes dhe deklarata e ofruar nga OE "MSS" Shpk nuk korrespondon me kërkesat e dosjes së tenderit, **paneli konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar** për faktin se OE "MSS" Shpk ka ofruar listën e pajisjeve siç është kërkuar nga Dosja e tenderit dhe kjo listë është noterizuar tek noteri Sefedin Blakaj me akt en-minutes, me nr të referencës 1956/19 dhe deklarata e noterizuar e përmbush kërkesën e dosjes se tenderit.

OE "MSS" Shpk ka ofertuar me çmim total prej 1,089,432.36 € dhe bazuar në analizën e shpenzimeve për pagat e 83 punëtorëve të pasqyruar më lartë(1,104,899.49 €) dhe sqarimeve shtese nga AK se çdo ofertë që nuk mbulon shpenzimet e pagave të 83 punëtorëve do të trajtohet si çmim jo normalisht i ulët. **Paneli shqyrtues vlerëson se oferta e OE "MSS" Shpk është nën pragun e mbulimit të shpenzimeve të pagave të punëtorëve dhe duke u bazuar në këtë paneli konsideron se pretendimi ankimor është i bazuar.**

Pretendimet e OE ankues "Krasniqi" Shpk për Grupin e OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Krasniqi" Shpk se Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin e mjeteve financiare për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, dëshmi deklarata tatimore mujore për tre vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit nga ATK por ka ofruar deklarata vjetore, paneli shqyrtues konstaton se Grupi i OE "Saf" Shpk; "Integral" Shpk në momentin e dorëzimit të ofertës përmes sistemit e-prokurimi ka dorëzuar edhe deklaratat tatimore vjetore (ATK) për vitet 2016,2017 dhe 2018. Nëse e marrim vetëm deklaratën tatimore të vitit 2018 ku të ardhurat bruto janë 6,631,732.86 € dhe deklaratën tatimore të vitit 2017 ku të ardhurat bruto janë 1,444,143.33 €, atëhere i bie që Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk ka përmbushur kërkesën për qarkullim financiar në shume prej 1,500.00 € për tri vitet e fundit **dhe pretendimi ankimor është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Krasniqi" Shpk se Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk nuk përmbush kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional, ku OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë) minimum 1,000,000.00 euro. Grupi i OE "Saf" Shpk ; "Integral" Shpk ka dorëzuar një listë të kontratave të bashkangjitur me referenca dhe kontrata për secilin anëtarë të konzorciumit.

Anëtarë konzorciumit OE "Saf" Shpk ka dorëzuar një kontrate të lidhur me 06.04.2016 me Komunën e Gjakovës për "Mirëmbajtjen e ndërtesave të drejtorive komunale për vitin 2016. Kjo kontratë nuk është e

dëshmuar me referencë dhe nuk dihet sa është shuma e kontratës së realizuar. Gjithashtu ka dorëzuar edhe një kontratë me Komunën e Vitisë për “Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore” e lidhur me 01.09.2017 deri me 31.08.2018 në vlerë prej 109,043.64 €. Nuk ka referencë të bashkangjitur për këtë kontratë. OE “Saf” ka dorëzuar edhe disa kontrata dhe referenca me operator privat për ofrimin e shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes por që nuk arrijnë ta përmbushin shumën e kontratave të realizuara prej 1,000,000.00€. Anëtari i konzorciumit OE “Integral” Shpk ka prezantuar listën e kontratave të bashkangjitur edhe disa kontrata dhe referenca, por lista e kontratave dhe kontratat me referenca nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme të kërkuar sipas DT. Pothuaj të gjitha kontratat e prezantuara janë kontrata për asfaltimin e rrugëve, mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrugëve regjionale dhe këto kontrata janë kontrata për punë dhe nuk përmbushin kërkesën e DT për kontratat të ngjashme, andaj **paneli shqyrtues e vlerëson si të bazuar pretendimin ankimor.**

Sa i përket pretendimit tjetër tek kapaciteti teknik/profesional se Grupi i OE “Saf” Shpk ; “Integral” Shpk nuk ka dorëzuar kontratat e punës për 6 punëtor për mbrojtje fillestare nga zjarri, lista e pajisjeve nuk është e noterizuar dhe nuk ka dorëzuar asnjë deklaratë për kërkesat 2,3,4 dhe 5 tek kapaciteti teknik/profesional i DT. Grupi i OE “Saf” Shpk ; “Integral” Shpk ka dorëzuar certifikatat e trajnimit për mbrojtje nga zjarri por nuk ka dëshmi për kontrata apo CV dhe pagesën e trustit pensional. Lista e pajisjeve për realizimin e punëve nuk është e noterizuar siç është kërkuar në DT. Deklaratat se OE do të punësoj 83 punëtorë (69+14), se do të paguaj pagën bruto prej 282.50 €, deklaratën se të drejtat e punëtorëve do të realizohen konform rregullave dhe ligjeve të aplikuara në Kosovës duke përfshirë edhe përvojën e punës, deklaratën se materialet e përdorura janë bio dhe të atestuara, kërkesa konform DT (kërkesa 2,3,4,dhe 5) nuk janë dorëzuar nga ky konzorcium. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Grupi i OE “Saf” Shpk ; “Integral” Shpk ka ofertuar me çmim total prej 1,094,949.62 € dhe bazuar në analizën e shpenzimeve për pagat e 83 punëtorëve të pasqyruar më lartë(1,104,899.49 €) dhe sqarimeve shtese nga AK se çdo ofertë që nuk mbulon shpenzimet e pagave të 83 punëtorëve do të trajtohet si çmim jo normalisht i ulët. Konsideroj se oferta e Grupit të OE “Saf” Shpk ; “Integral” Shpk është nën pragun e mbulimit të shpenzimeve të pagave të punëtorëve dhe duke u bazuar në këtë paneli konsideron se pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues konstaton se pavarësisht konstatimeve të mësipërme të dhëna lidhur me pagat dhe formulat e paraqitura nga Autoritetin Kontraktues dhe nga Eksperti shqyrtues profesional i prokurimit, Autoriteti Kontraktues është i Obliguar që konform të gjitha ligjeve në fuqi (duke marrë interpretime nga institucionet kompetente si. Psh. ATK etj) të vërtetoj saktësisht, tabelën lidhur me pagat dhe kontributet.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raportin e ekspertizës nga eksperti shqyrtues profesional, konform konstatimeve të dhëna në secilin pretendim ankimor veç e veç, konstaton se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së, obligohet AK që kete AP ta rivlerësoj konform nenit 7, 59, 60, 61 dhe 72 të LPP-së si dhe ti respektoj në përpikëri të gjitha dispozitat tjera të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –“Kuvendi Komunal Prishtinë”,
- 1x1 “LAGUNA” SH.P.K – Prishtinë,
- 1x1 “Krasniqi” SH.P.K – Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.